



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 464 Prot.
01

Tiranë, më 20.04.2023

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTIN E RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, të Vendimit Nr. 2, datë 27.04.2018 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kavajë", Vendimit Nr. 7 datë 28.12.2020 të KKT-së "Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kavajë, të miratuar me Vendimit Nr. 2, datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit", të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit, të dhënave elektronike bazë, si dhe Raportit të Vlerësimit Teknik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, bashkia Kavajë.
2. Akti i përputhshmërisë lëshohet me kusht që, përpara miratimit të dokumentit të rishikimit në Këshillin Kombëtar të Territorit, bashkia, në zbatim të Ligjit Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" të pres qëndrimin nga Ministrisë së Mjedisit dhe Turzmit (se rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor nuk ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të VSM-së).

ADELINA GREÇA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

